DH. ANKESAT

- 25. Procedura e ankesës**
1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
 2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Kundër vendimit të autoritetit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

- 26. Anulimi i procedurës**
1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
 2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;
- Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.
3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të

njëtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1:Formulari i OfertësEkonomike

Shtojca 2:Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

Shtojca3:Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratëmbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca7:Formulari i shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit.....

Shtojca 8: Termat e Referencës

Shtojca9: Formulari i Krieteve te Përzgjedhjes se Ofertuesve

Shtojca10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.....

Shtojca11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.....

Shtojca12: Formulari i Njoftimit të Fituesit pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Formulari 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit në përfundim të afateve tëankimit

Shtojca14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadërpas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 15:Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit tëProcedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËSEKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomikshënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimetpër **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimevesipas elementëve përbërës të shërbimitdhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁵Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë
(në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					

Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr.Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(*Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik*)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik "....." për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik "....." të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt _____, është i pamiratuuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6 .

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeveobjekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen që kërkohen: "Hartim Projekti "Për ndërtimin e një vepre hidroteknike, kanal shkarkues dhe rikonstruksioni i linjës KUZ në qytetin e Belshit"

Afatet e ekzekutimit: 90 (nentedhete)dite nga nenshkrimi i konterates.

Shërbimet	Përshkrimi	Shuma	Vendi i ekzekutimit	Afati i ekzekutimit
	"Hartim Projekti "Për ndërtimin e një vepre hidroteknike, kanal shkarkues dhe rikonstruksioni i linjës KUZ në qytetin e Belshit"	1	BASHKIA BELSH	90 (nentedhete)dite nga nenshkrimi i konterates.

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Detyrat:

Shpërndarja:

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve:

DETYRË - PROJEKTIMI

PËR HARTIMIN E PROJEKTIT:

Ndertimin e një vepre hidroteknike "Lane" kanal shkarkues i ujërave të bardha dhe rikonstruksioni i linjës së KUZ-sënë qytetin e Belshit.

BASHKIA BELSH

BELSH 2026

❖ *HYRJE*

Bashkia e Belshit kufizohet në veri me bashkinë Peqin, në lindje me bashkinë Cërrrik, në jug me bashkinë Kuçovë dhe në perëndim me bashkinë Lushnje. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Belshit. Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, kjo bashki numëron 19,503 banorë dhe densitet prej 99.28 banorë për km², ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil kjo bashki ka një popullsi prej 32,389 banorë dhe densitet prej 168.88 banorë për km². Sipërfaqja e bashkisë së re është 196.44 km². Kjo Bashki përbëhet nga 5 njësi administrative, të cilat janë: Belsh, Grekan, Kajan, Fierzë dhe Rrasë. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Elbasanit dhe qarkut të Elbasanit. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 34 fshatra.

❖ *OBJEKTIVI*

Qëllimi i këtij projekti është studimi i plotë, rehabilitimi dhe optimizimi i sistemit ekzistues të kanaleve kulluese dhe vaditëse në zonën e Belshit, me synim rritjen e eficiencës së menaxhimit të ujërave sipërfaqësore dhe të ujërave të shiut. Nëpërmjet këtij projekti synohet të reduktohet rreziku i përmytjeve në zonat urbane dhe rurale, të përmirësohet funksionimi hidraulik i rrjetit ekzistues dhe të krijohen kushte për përdorimin racional të burimeve ujore për vaditje gjatë periudhave të thatësirës.


Njëkohësisht, projekti synon të garantojë një menaxhim të qëndrueshëm të nivelit të liqenit të Belshit, duke siguruar kontrollin automatik të shkarkimeve dhe mundësinë e furnizimit të sistemit me ujë në kushte të mungesës së reshjeve.

Linja nr.1 e kanali ekzistues te hapur

Linja nr.2 e kanalit ekzistues te mbyllur

Linja nr.3 eshkatkimit te KUB & KUZ f-1000m

Linja ne. 4 e shkarkimit te liqenit e cila nuk do preket



❖ **OBJEKTI I PROJEKTIT**

Objekti i projektimit përfshin analizën, verifikimin dhe projektimin e ndërhyrjeve në sistemin ekzistues të përbërë nga katër linja kryesore, të cilat funksionojnë në mënyrë të ndërlidhur.

Linja nr. 1 përfaqëson kanalin ekzistues të hapur, i përbërë nga dy degë kryesore që mbledhin ujërat sipërfaqësore nga një sipërfaqe e gjerë që përfshin zonat midis fshatrave Trojas, Qafë Shkallë, Shegas, Rrasë e Sipërme dhe Stanaj. Kjo linjë ka rol parësor në kullimin e ujërave dhe kërkon ndërhyrje për pastrim, sistemim të seksionit, stabilizim të skarpateve dhe, aty ku është e nevojshme, veshje mbrojtëse për të parandaluar erozionin dhe degradimin.

Linja nr. 2 është kanali ekzistues i mbyllur që kalon nëpër qytetin e Belshit dhe përbën vazhdimin hidraulik të linjës nr. 1. Për këtë segment kërkohet një vlerësim i detajuar i gjendjes ekzistuese dhe parashikimi i ndërhyrjeve rehabilituese për përmirësimin e kapacitetit dhe funksionimit, përfshirë ndërtimin e pusetave të kontrollit dhe mirëmbajtjes.

Linja nr. 3 është linja kryesore e shkarkimit, e realizuar me tubacione me diametër Ø1000 mm, e cila përçon ujërat e shiut të mbledhura nga linjat nr. 1 dhe nr. 2, si dhe ujërat që vijnë nga liqeni i Belshit. Në këtë linjë shkarkohen gjithashtu edhe ujërat e zeza të zonës urbane, duke bërë atë një element me rëndësi të veçantë. Projekti duhet të përfshijë verifikimin e kapacitetit të saj, vlerësimin e gjendjes teknike dhe, nëse është e mundur, analizën për ndarjen e rrjeteve të ujërave të bardha dhe të zeza.

Linja nr. 4 përfaqëson segmentin e shkarkimit të liqenit, i cili është rikonstruktuar së fundmi dhe nuk parashikon ndërhyrje strukturore. Megjithatë, në pikën e bashkimit me linjat nr. 2 dhe nr. 3, duhet të parashikohet instalimi i një porte automatike rregulluese, e cila do të mundësojë shkarkimin e kontrolluar të ujit nga liqeni kur niveli arrin kuotën maksimale, si dhe furnizimin e sistemit me ujë gjatë periudhave të thatësirës.

❖ **Studimi i ujëmbledhësit dhe analiza hidrologjike**

Në kuadër të projektimit, një rëndësi të veçantë ka përcaktimi i sipërfaqes së ujëmbledhësit që ushqen linjën nr. 1. Projektuesi duhet të identifikojë dhe të përcaktojë me saktësi kufijtë e pellgut ujëmbledhës, duke u bazuar në analizën e relievit dhe të rrjedhjes natyrore të ujërave sipërfaqësore në zonën që përfshin fshatrat Trojas, Qafë Shkallë, Shegas, Rrasë e Sipërme dhe Stanaj.

Ky proces duhet të realizohet nëpërmjet përdorimit të të dhënave topografike të detajuara dhe modeleve digjitale të terrenit (DTM/DEM), duke identifikuar drejtimet e rrjedhjes dhe kufijtë

natyrorë të pellgut. Në rast se zona paraqet kompleksitet, duhet të kryhet ndarja në nën-ujëmbledhësa për një analizë më të saktë.

Studimi duhet të përfshijë gjithashtu analizën e karakteristikave të tokës, përdorimit të saj, mbulesës bimore dhe pjerrësive, si dhe përcaktimin e kohës së përqendrimit. Në bazë të këtyre të dhënave, duhet të kryhen llogaritjet hidrologjike për përcaktimin e prurjeve maksimale, duke përdorur metoda të përshtatshme si metoda racionale ose metoda të tjera të njohura.

Rezultatet e këtij studimi duhet të paraqiten në formën e hartave të pellgut ujëmbledhës, sipërfaqes totale të tij, parametrave hidrologjikë dhe prurjeve llogaritëse për skenarë të ndryshëm të reshjeve.

❖ *Detyrat e projektuesit*

Projektuesi duhet të realizojë një analizë të plotë të gjendjes ekzistuese të sistemit, duke përfshirë rilevimin topografik, evidentimin e rrjetit ekzistues dhe vlerësimin e gjendjes fizike dhe funksionale të çdo elementi.

Në vijim, duhet të kryhen llogaritjet hidraulike për verifikimin dhe dimensionimin e kanaleve dhe tubacioneve, duke marrë në konsideratë prurjet e përcaktuara nga analiza hidrologjike dhe skenarët e kushteve ekstreme.

Bazuar në këto analiza, projektuesi duhet të hartojë projektin teknik të detajuar, që përfshin planimetritë, profilet gjatësore dhe tërthore, si dhe detajet konstruktive të të gjitha ndërhyrjeve, përfshirë strukturat e kontrollit dhe sistemet e automatizimit.

Gjithashtu, duhet të hartohen preventivi i punimeve, specifikimet teknike dhe grafiku i realizimit, duke siguruar realizueshmërinë teknike dhe ekonomike të projektit. Bvc

❖ *KUADRI LIGJOR*

Në mbështetje të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, si dhe nenit 20 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, me Vendim Nr. 377, datë 12.6.2024 Për Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr. 408, Datë 13.5.2015, Të Këshillit të Ministrave, “Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”,

Projektuesi duhet të kryejë të gjithë punën në përputhje me standardet e projektimit dhe ndërtimit që janë në fuqi në Shqipëri. Te ligjit Nr.8402, date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” I ndryshuar.

1. HARTIMI I PROJEKTIT

❖ *Standardet*

Projekti i kompletuar i paraqitur për objektin:

“Ndertimin e një vepre hidroteknike “Lane” kanal shkarkues i ujërave të bardha dhe rikonstruksioni i linjës së KUZ-së në qytetin e Belshit”

Projekti duhet të hartohet mbështetur dhe në zbatim të **Planit të Pergjithshëm Vendor Belsh, akteve ligjore apo nënligjore në fuqi për Kushtet Teknike të Projektimit** duke marrë në konsideratë kushtet dhe kriteret e veçanta në rastin e projektimit apo zbatimit të ndërtimit të sistemeve vaditese me presion, veterredhje, si dhe me kanele vadites, të marrë në konsideratë Kushtet Teknike të Zbatimit që janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë si dhe Standardet në fuqi për normat dhe kriteret specifike të projektimit si dhe ndjekja e procedurave deri në miratimin e lejes së ndërtimit.

Eshtë përgjegjësi e Projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standarteve dhe normave përkatëse.

Projektuesi mund të rekomandojë edhe prezantimin e standareve të reja si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim.

Hartimi i preventivit do të realizohet në përputhje me cmimet e referencës do të jenë sipas legjislacionit në fuqi (Manuali Teknik i Çmimeve V.K.M nr.216, datë 13.04.2023).

Preventivi të hartohet i ndare për çdo segment të rrugëve si me sipër.

❖ **Dorëzimi i Projektit**

Dorëzimi i Projektit të përmbyllet brenda një afati prej 90 ditësh.

Afati i parashikuar për komente nga Autoriteti Kontraktor nuk përfshihet në afatin e realizimit të shërbimit nga konsulentit.

Projekt zbatimi do të përmbajë të gjithë materialin e përmendur më sipër.

❖ **Dokumentacioni përfundimtar duhet të përmbajë:**

- Rilevim Topografik/Gjeodezik sipas kërkesave të projektit në këto detyra projektimi në formatin A3.
- Projektin Hidroteknik sipas kërkesave të projektit në këto detyra projektimi në formatin A3;
- Relacion Hidroteknik;
- Specifikimet teknike për zerat e punimeve që do të kryhen;
- Planvendosja dhe planimetria e e linjave kryesore, skondare, profilet terthore dhe gjatesore në shkallën 1:2500 në formatin A3, me të gjitha koeficientet e treguesit të zhvillimit në përputhje me ligjin Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 i ndryshuar dhe VKM Nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar si dhe PPV-ne Belsh për të bërë të mundur kërkesën e përputhshmerisë së projekt zbatimit si dhe aplikimin për leje ndërtimi në portalin e-leje;
- Projekti Teknik;
- Relacioni teknik;
- Raport hidrogeologjik;
- Grafikon të detajuar sipas zerave të punës;
- Preventiv;
- Raporti Paraprak i VNM-se;
- Raport Gjeologjik
- Rekomandime për materialet e ndërtimit që do të përdoren.

Gjithashtu projektuesi duhet të paraqesë:

- Liçenca e Studios së Projektimit + Deklarata e Përgjegjësive Profesionale + Polica e Sigurimit;
- Liçenca e inxhinierit Gjeodet+ Deklarata e Përgjegjësive Profesionale + Polica e Sigurimit;
- Liçenca e inxhinierit të Ndërtimit + Deklarata e Përgjegjësive Profesionale + Polica e Sigurimit;
- Liçenca e inxhinierit Gjeolog + Deklarata e Përgjegjësive Profesionale + Polica e Sigurimit
- Liçenca e inxhinierit Hidroteknik + Deklarata e Përgjegjësive Profesionale + Polica e Sigurimit;
- Certificate/Liçenca e ekspert/inxhinierit të Mjedisit+ Deklarata e Përgjegjësive Profesionale + Polica e Sigurimit;

❖ **Rekomandime për projektuesin**

- Projektuesi duhet të përdorë çdo dokumentacion ekzistues në lidhje me gjurmën ekzistuese do të ndërtohet ky objekt.
- Cilësia e projektimit duhet të jetë e tillë që të arrihet në standartin e kërkuar.
- Projektuesi duhet të hartojë projektin në përputhje me Ligjin nr.8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar.

❖ **Organizimi, plani i punës dhe stafi i kërkuar**

Projekti do të kryhet në bashkëpunim të ngushtë me Autoritetin Kontraktor. Stafi që kërkohet duhet të mbulojë:

- Inxhinier Ndertimi;
- Inxhinier Hidroteknik;
- Inxhinier Gjeolog;
- Preventivues sipas fushave te mesiperme ;
- Inxhinier Gjeodet;
- Ekspert/Inxhinier Mjedisi;
- Staf mbështetës për fushat e mësipërme;

Raportimi/paraqitja

Në hartimin, paraqitjen dhe miratimin e dokumentacionit teknik të projektit të merren parasysh dhe të respektohen të gjitha kërkesat dokumentare dhe të paraqitjes që parashikon Ligji “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, dhe dispozitat nënligjore në zbatim të tij si dhe ndjekjen e procedurave ligjore deri në miratimin e Lejes së Ndërtimit nga Autoritetet.

Raportet dhe dokumentat duhet të jenë në 3 (tre) kopje, në gjuhën shqipe dhe të jenë te printuar me ngjyra. Vizatimet duhet të jenë të lexueshme në formatin “DWG” (AutoCad 2006-2024).

Ne projekt do te paraqiten te gjitha detajet, skicat dhe udhezimet e domosdoshme per realizimet e punimve.

Ne projekt do te shenohet vend - depozitimi i mbetjeve dhe treguesit e distancave nga secili rruge deri tek venddepozitimi i mbetjeve.

Të gjitha materialet do të dorëzohen në hard-copy (në 2kopje te firmosur dhe vulosur me vule te njome) si dhe te dorezohet i vulosur elektronikisht me vule dixhitale nga projektuesit drejtuesiligjor.

Shtojca 9.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas përcaktimeve të bëra në shtojcës 9) të DST-ve (Kriteret e Përgjithshme të perzgjedhjes /Kualifikimit).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024,2025) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të fondit limit që prokurohet. *Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Shënim: *“Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 41 pika 2 ku përcaktohet se: “Kërkesa të veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi ”*

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të maturuara të parashikuara nga Pushteti Vendor **për vitin 2025** sipas Ligjit Nr. 9632, datë

30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar); prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe **vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vitin e fundit (këstet e maturuara), duke mbajtur në konsideratë edhe përcaktimet e Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” I ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore (këstet e maturuara për vitin 2026).**

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës.

Shënim: *Në procedurat e prokurimit me një fazë,” përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.*

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohet dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, në një vlerë **jo më të vogël se 20%** të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, *Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.*

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë, Liçence profesionale për shoqërinë, sipas VKM nr. 943, date 28.12.2016, e vlefshme për kategoritë në fushat e studimit dhe projektimit në ndërtim lëshuar nga MIE dhe/ ose MZHU dhe/ose nga cdo Institucioni i Autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studimit e projektimit në ndërtim, për këto kategori:

KAT 3. PROJEKTUES KONSTRUKTOR

a)- Objekte civile - industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.

Kat 5. PROJEKTUES VEPRRA HIDRAULIKE

b)- Furnizim me ujë – kolektorë shkarkimi.

f)- Vepra hidroteknike, galeri e tunele hidraulike, marrje uji, shkarkimi- shkarkues të ujërave të tepërta, vepra të marrjes së ujit nga rezervuarët, vepra të marrjes së ujit nga lumenjtë dhe marrja e ujit me puse.

Kat. 8. PROJEKTUES GJEODET

a) – Rilevime inxhinierike.

Kat. 9. STUDIM GJEOLGJIKO INXHINIERIK – HIDROLOGJIK

d)– Studime e projektme hidrogeologjike.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet te disponoje nje ekspert per ceshtjet mjedisore te pajisur me License/Certifikat për hartimin e Vlerësimit te Ndikimit në Mjedis(VNM) dhe auditimin mjedisor sipas legjislacionin ne fuqi, te vertetuar me kontrate pune te vlefshme dhe certifikate.

Shënim: Në procedurat e prokurimit me një fazë, ” përpapa publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të kete te punësuar mesatarisht të paktën **4 (kater) punonjës** për periudhen **Shkurt 2026 – Prill 2026**.

Për këtë ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, per periudhen e fundit te deklaruar ,ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin nga muajt e kerkuar;
- b) Listepagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen e fundit te deklaruar, shoqëruar me formularet e deklarimit te pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetesore.

Shënim: Në procedurat e prokurimit me një fazë, ” përpapa publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të ketë ne Licensen e Shoqerisë stafin si me poshte, vertetuar me kontrate pune te vlefshme, diplome, licence profesionale individuale dhe te jene te perfshire ne Listpagesën e Kontributeve te Sigurimeve Shoqerore dhe Shendetesore dhe TAP, si me poshte :

- 1 (një) inxhinier hidroteknik,
- 1 (një) inxhinier gjeodet,
- 1 (një) inxhinier gjeolog
- 1 (nje) inxhinier konstruktiv;

a) Si dëshmi për stafin e mësipërm të paraqiten dokumentet si Diploma, Liçencat profesionale personale të projektimit, Kontrata e punës si dhe të figurojnë në Listë pagesat e punonjësve të shoqërisë për periudhen Shkurt 2026 – Prill 2026. Për këtë si dëshmi duhet të dorëzohen listë pagesat perkatese.

Shënim: Në procedurat e prokurimit me një fazë, ” përpapa publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera:

- 1(nje) Pajisje për matjet gjeodezike GPS ose 1(nje) Pajisje për matjet gjeodezike Total Station;

Shënim: Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhena të rreme osetë pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 10.

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT -i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarimenëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <p>_____</p> <p>_____</p> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
